



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI EKONOMIK
DEKANATI**

Nr. extra prot.

Elbasan, më 17.03.2020

**UDHËZIM
Nr.1, datë 17.03.2020**

**“PËR
ZHVILLIMIN E PROCESIT MËSIMOR ONLINE NË FAKUTETIN
EKONOMIK TË UNIVERSITETIT TË ELBASANIT “ALEKSANDËR
XHUVANI”**

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 43, të Statutit të Universitetit “A.Xhuvani”, miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UE-së Nr.5 datë 30.01.2018, neni 19, si dhe në zbatim të Vendimit të Rektorit të UE-së, të datës 17.03.2020 “Për zhvillimin e procesit mësimor online në Universiteti e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, Dekanati i Fakultetit Ekonomik të UE-së, pas diskutimeve virtuale të zhvilluara në datën 17.03.2020, mbi mënyrat më oportune për zhvillimin e procesit mësimor online në Fakultetin Ekonomik dhe pasi mori në konsideratë edhe sugjerimet e stafit akademik të FE-së, duke shprehur vullnetin disponues të anëtarëve të tij në mënyrë virtuale qarkulluese,

UDHËZON:

1. Në zbatim të Urdhërit të Rektorit dhe Udhëzimit të MASR, procesi mësimor në Fakultetin Ekonomik të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të zhvillohet online në mënyrë virtuale.
2. Zhvillimi i procesit mësimor on line të bëhet duke filluar më datë 17.03.2020 e deri në daljen e një vendimi të dytë për fillimin e procesit mësimor në auditore me prezencë fizike.
3. Procedurat e zhvillimit të procesit mësimor online do të realizohen si më poshtë:
 - 3.1. Çdo pedagog i stafit akademik të Fakultetit Ekonomik, sipas ngarkesës së semestrit të II, të vitit akademik 2019-2020:
 - a. Përcakton një nga format online të komunikimit në grup, sipas përcaktimeve në këtë udhëzim.
 - b. Krijon grupin virtual të programit të studimit me studentët e grupit, sipas planit mësimor. Grupi virtual i studimit krijohet me të gjithë, apo më shumicën e studentëve të atij grupi studimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
FAKULTETI EKONOMIK
DEKANATI**

- c. Jep udhëzime, materiale, leksione në formate të ndryshme për grupin e krijuar, lidhur me përvetësimin e lëndës përkatëse. Formatet e materialeve mund të jenë në “word”, “pdf”, “power point”, “excel”, etj.
 - d. U përgjigjet pyetjeve të studentëve për çështje të ndryshme të mësimin.
 - e. Jep detyra dhe ushtrime lidhur me lëndët në varësi të veçantive të secilës lëndë.
 - f. Ndjek ecurinë e përgatitjes së detyrave të kursit, si dhe të studentëve që po përgatitin tezat e diplomës.
 - g. Informon përgjegjës të njësive bazë për ecurinë e zhvillimit të mësimin online.
 - h. Dokumenton zhvillimin e mësimin në evidencat përkatëse.
4. Sistemet virtuale të komunikimit në grup, për zhvillimin e procesit mësimor online, të zgjidhen nga pedagogët duke marrë në konsideratë interesat e lëndës respektive, si më poshtë:
- Google Clasroom
 - WhatsApp
 - Viber
 - e-mail
 - facebook
 - skype
 - të tjera.
5. Ngarkohen përgjegjësit e departamenteve të FE-së për ndjekjen e zbatimit të këtij Udhëzimi.
6. Personeli ndihmës-akademik mbështet dhe lehtëson zhvillimin online të procesit mësimor.
7. Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DEKANI

Prof.as.Dr.Imelda Sejdini